



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:240688  
Datë: 23.11.2022  
Numri i dokumentit: 03679946

C.nr.441/16

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses TEB Sh.a me seli në P. rruga “A. R.” nr.... .., i përfaqësuar nga D. L. R. me seli në . rruga “E. M.” nr...., me autorizim D. R. kundër të paditurit S. V. me adresë të fundit në V. rruga “G.K. S.”, me adresën e precizuar nga paditësja . D. P-P., kati i .., V. me objekt kontesti pagesë e borgjit, me vlerë të kontestit 372.94 euro, jashtë seance, me datë 23.11.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

PADIA e paditëses TEB Sh.a me seli në P., rr. “A. R.” nr..., .., i përfaqësuar nga D. L. R. me seli në P., rr. “E. M.” nr..., me autorizim D.R., kundër të paditurit S. V. me adresë të fundit në V., rruga “Gj.K. S.”, me adresën e precizuar nga paditësja R. D. P-P1, kati i .. .., në këtë çështje kontestimore KONSIDEROHET E TËRHEQUR.

A r s y e t i m

Paditësja TEB Sh.a me seli në P., rruga “A. R.” nr.... .., përmes të autorizuarës së saj në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit S.V. me adresë të fundit në Vushtrri, rruga “Gj. K.S.”, me adresën e precizuar nga paditësja R. D. P-P1, kati ... , V..., me bazë juridike Pagesë e borgjit me vlerë të kontestit 372.94 euro.

Pas disa precizimeve të pasakta të adresës së të paditurit të bëra nga e autorizuarja e paditëses, gjykata me aktvendimin C.nr.441/16 të datës 01.11.2022, e ka obliguar përfaqësuesen e paditëses që në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, ta precizoj padinë me adresën e saktë

të të paditurit S. V.. E autorizuar e paditëses nuk ka dorëzuar parashtrësë për precizimin e adresës së paditëses.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 102 par.3 lidhur me nenin 261 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.441/16, me datë 23.11.2022

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtut, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.